

V E N D I M
Nr.448, datë 16.7.1998

**PËR KONTROLLIN DHE ADMINISTRIMIN E PERSONAVE FIZIKË A JURIDIKË QË
KANË GRUMBULLUAR KAPITALE OSE LETRA ME VLERË NGA PUBLIKU I
GJERË**

Në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankar, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kontrollit financiar dhe administrimit, në bazë të dispozitave të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, do t'i nënshtrohen edhe personat fizikë a juridikë, të cilët më poshtë do t'i quajmë subjekte kontrolli, që kanë grumbulluar kapitale ose letra me vlerë nga publiku i gjerë.

2. Si subjekt kontrolli, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, konsiderohen:

- | | |
|-------------------|---------|
| - Fabiona sh.p.k. | Tiranë |
| - Flora & Co | Tiranë |
| - Aserd | Tiranë |
| - Universi | Vorë |
| - Agroni | Tiranë |
| - Kambo-Marshall | Tiranë |
| - Nahlel | Lushnjë |
| - 2K | Tiranë |

3. Ekspertët financiarë të pavarur dhe administratorët ushtrojnë kompetencat e tyre në funksion të kërkesave të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997, ndryshuar me ligjin nr.8227, datë 30.7.1997, deri në kthimin e vlerave financiare kreditorëve të secilit subjekt, duke zbatuar në këto raste, të gjitha aktet ligjore të dala për shoqëritë që kanë grumbulluar kapitale nga publiku i gjerë.

4. Për plotësimin e detyrave ekspertët lokalë të pavarur dhe administratorët kërkojnë nga personat fizikë e juridikë tërë dokumentacionin e nevojshëm financiar dhe atë që lidhet me procesin e huamarrjes ose të grumbullimit të letrave me vlerë për secilin kreditor, që ka investuar në to.

5. Kontrolli dhe administrimi i personave fizikë a juridikë, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, zgjat për një periudhë kohe 3-mujore nga dita e fillimit dhe brenda vitit 1998.

6. Lista e personave që do të caktohen si ekspertë kontabël dhe administratorë pranë personave fizikë e juridikë, përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, bëhet nga Grupi i Mbikëqyrjes, duke pasur parasysh vëllimin e punës, madhësinë e huamarrjes dhe numrin e kreditorëve, që kanë investuar kapitalet e letrat me vlerë.

7. Grupi i Mbikëqyrjes i paraqet Këshillit të Ministrave për secilën nga shoqëritë e mësipërme, në përfundim të procesit të kontrollit e të administrimit, skemën që duhet

zbatuar për kthimin dhe kompensimin e vlerave kapitale kreditorëve që kanë investuar pranë tyre.

8. Për realizimin e detyrave të caktuara në këtë vendim, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, Grupit të Mbikëqyrjes i shtohet në planin financiar të vitit 1998 për shpenzimet e grupit të administratorëve për subjektet e caktuara në pikën 2 të këtij vendimi, një fond prej 3.5 milionë lekësh, i cili do të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

9. Paga bazë mujore e ekspertëve financiarë dhe administratorëve që do të caktohen në këtë shoqëri është 35 mijë lekë në muaj.

10. Për zbatimin e detyrave të caktuara në këtë vendim ngarkohen Ministria e Financave dhe Grupi i Mbikëqyrjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano